



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljenj / Pristato Received / Delivery	27-03-2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHACK	3024/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.358/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses. ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.358/2023 të datës 14.02.2023, të parashtruar nga ankuesja me adresë rr."Bedri Gjinaj" në Komunën e Mitrovicës së Jugut, kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.358/2023 të datës 14.02.2023, të parashtruar nga ankuesja
- II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut sipas Akt emërimit të datës 26.10.2022 në pozitën "Receptioniste" në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme, Sektori-Qendra për Shërbime të Qytetarëve, me datën 27.01.2023 ka parashtruar kërkesën me numër 02 Nr.Prot.01-112/01-0007077/23 tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të kësaj komune për lëshimin e akt emërimit në pozitën si zyrtare në Qendrën për Shërbim me Qytetarë. Ndërsa ky i fundit me datën 30.01.2023 përmes shkresës me numër 01-112/01-0007077-2/23, është përgjigjur në kërkesën e ankueses dhe ka deklaruar se për rastin e ankueses nuk kanë gjetur asnjë vendim për transferim nga pozita e receptionistes në atë si Zyrtare në QSHQ dhe mbi këtë fakt meqë nuk ka bazë ligjore nuk

mund ti lëshohet akt emërimi ankueses nga recepsioniste në zyrtare në qendrën për shërbime me qytetarë.

E pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit, ankuesja me datën 10.02.2023 përmes postës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar me datën 14.02.2023 sipas shkresës së protokollit 1737/2023, me pretendimet ankimore për njohjen e të drejtës së harmonizimit të akt emërimit në pozitën si zyrtare për shërbime me qytetarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 23.02.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2002/2023 tek Komuna e Mitrovicës së Jugut, ndërsa kjo e fundit me datën 07.03.2023 përmes shkresës me numër të protokollit 2463/2023 ka përcjellë përgjigjen së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot: 1737/2023 të datës 14.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën e ankueses me Nr.Prot.01-112/01-0007077/23 të datës 27.01.2023 e parashtruar tek Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës; Përgjigjen në kërkesë me numër 01-112/01-0007077-2/23 të datës 30.01.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës; Kërkesën përmes e-mailit zyrtar të datës 26.01.2023 drejtuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 07.03.2023 nga Komuna e Mitrovicës së Jugut së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankueses të datës 26.10.2011; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit me numër 01-112-27849 të datës 01.11.2013; Vendimin Nr.01-031-76757 të datës 11.08.2015 për caktimin e përkohshëm të nëpunësit civil; Vendimin Nr.01-130/07-0043721-2/20 të datës 04.08.2020 lidhur me lejimin e pushimit të lehonisë; Vendimin Nr.01-130/07-0001401-2/20 të datës 22.01.2021 lidhur me ndërprerjen e pushimit të lehonisë si dhe Vendimin Nr.01-130/07-0031824-2/2021 të datës 30.04.2021 lidhur me lejimin e pushimit me pagesë për ankuesen.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e ankueses** , *sepse:*

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me atë që të njëjtës ti bëhet harmonizimi i Akt emërimit në pozitën si Zyrtare për Shërbime me Qytetarë nga ajo e Recepsionistes, pas analizimit të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesja ka themeluar marrëdhënie pune tek Komuna e Mitrovicës së Jugut sipas Akt emërimit të datës 26.10.2011 në vendin e punës si "Recepsioniste" në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme, Sektori-Qendra për Shërbime të Qytetarëve. Lidhur me çështjen në fjalë Kolegji nuk ka gjetur asnjë provë në drejtim të asaj se ankuesja me vendim është transferuar nga pozita e "Recepsionistes" në atë si "Zyrtare" ose që është zhvilluar procedurë e rekrutimit lidhur me pozitën e ankueses të cilën aktualisht e mban, fakt ky që është vërtetuar edhe nga organi i punësimit përmes kërkesës për përgjigje të datës 30.01.2023, e dhënë nga ana e Menaxherit të Burimeve Njerëzore, ku i njëjti ka deklaruar se, citoj: "*....duke u bazuar në dosjen tuaj personale, nuk kemi gjetur asnjë vendim që jeni transferuar nga pozita recepsioniste në zyrtar në QSHQ, edhe përkundër faktit që unë e di që sa kohë jeni në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, mirëpo nuk kemi mundësi të ju lëshojmë akt emërim si zyrtare në Qendrën për Shërbim me Qytetarë pasi që nuk kemi bazë ligjore*".



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës*” si dhe bazuar në paragrafin 6 të të njëjtit nen ku theksohet se: *“Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike”*, konstatoi se pozita “Receptioniste” hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit administrativ dhe mbështetës, rrjedhimisht pozita në fjalë nuk është pozitë e shërbimit civil. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.358/2023 të datës 14.02.2023 të parashtruar nga ankuesja

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson se nëpunësi administrativo-teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohet tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesja nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lenda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.358/2023, datë 27/03/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut;
- Komisionit të Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

